



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. 196 / Prot.
4

Tiranë, më 31.03.2023

U D H Ë Z I M

Nr. 2, datë 31.03.2023

**PËR
CAKTIMIN E TARIFAVE TË VEPRIMTARISË DYTËSORE TË PËRMBARUESIT
GJYQËSOR PRIVAT PËR KRYERJEN E NJOFTIMIT TË AKTEVE GJYQËSORE
DHE DOKUMENTEVE ZYRTARE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës, të nenit 7, pika 2, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe të neni 36, pika 2, të ligjit nr. 26/2019, “Për shërbimin përmbarrimor gjyqësor privat”,

U D H Ë Z O J:

I. Objekti i udhëzimit

Objekti i këtij udhëzimi është përcaktimi i tarifave për kryerjen e njoftimit të akteve gjyqësore dhe dokumenteve zyrtare nga përmbarruesit gjyqësorë privatë, me kërkesë të të interesuarve ose me autorizim të gjykatës, si dhe mënyrës së pagesës së tyre.

II. Fusha e zbatimit të udhëzimit

Ky udhëzim zbatohet në rastet e:

- a) kryerjes së njoftimit të akteve gjyqësore dhe dokumenteve zyrtare, me kërkesë të gjykatës;
- b) kryerjes së njoftimit të dokumenteve zyrtare, me kërkesë të personave fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë.

III. Tarifa e shërbimit të njoftimit të dokumenteve zyrtare

1. Tarifa e njoftimit të dokumenteve zyrtare është pagesa që kryhet nga i interesuari për të mundësuar ofrimin e shërbimit të përmbarruesit gjyqësor privat për njoftimin e tyre.

2. Për kryerjen e njoftimit të dokumenteve zyrtare, me kërkesë të personave fizikë dhe juridikë privatë, vlera e tarifës përlllogaritet si më poshtë:

a) kur nuk kryhet njoftimi në adresën e deklaruar dhe adresa e deklaruar është e saktë, tarifa është 5 000 (pesë mijë) lekë;

b) kur nuk kryhet njoftimi në adresën e deklaruar dhe adresa e deklaruar është e pasaktë, tarifa është e barabartë me shumën që rezulton prej mbledhjes së vlerës prej 7 000 (shtatë mijë) lekësh dhe vlerës së tarifës për konstatimin e adresës, të parashikuar në udhëzimin në fuqi të ministrit të Drejtësisë;

c) kur njoftimi kryhet në adresën e deklaruar në një qytet tjetër, tarifa është e barabartë me shumën që rezulton prej vlerës 10 000 (dhjetë mijë) lekësh dhe vlerës së parapaguar të shpenzimeve të udhëtimit dhe qëndrimit;

ç) kur njoftimi kryhet në adresën e padeklaruar në një qytet tjetër, tarifa është e barabartë me shumën që rezulton prej mbledhjes së vlerës së gjysmës së pagës minimale në shkallë vendi, vlerës së parapaguar të shpenzimeve të udhëtimit dhe qëndrimit, si dhe tarifës për konstatimin e adresës, të parashikuar në udhëzimin e ministrit të Drejtësisë.

3. Për kryerjen e njoftimit të dokumenteve zyrtare, me kërkesë të personave juridikë publikë, vlera e tarifës përlogaritet si më poshtë:

a) kur nuk kryhet komunikimi në adresën e deklaruar dhe adresa e deklaruar është e saktë, tarifa është e barabartë me shumën që rezulton prej mbledhjes së vlerës së gjysmës së pagës minimale në shkallë vendi dhe vlerës së parapaguar të shpenzimeve të udhëtimit dhe qëndrimit;

b) kur nuk kryhet komunikimi në adresën e deklaruar dhe adresa e deklaruar është e pasaktë, tarifa është e barabartë me shumën që rezulton prej mbledhjes së vlerës së një page minimale në shkallë vendi dhe tarifës për konstatimin e adresës, të parashikuar në udhëzimin në fuqi të ministrit të Drejtësisë;

c) kur njoftimi kryhet në një njësi administrative tjetër të një qarku tjetër, tarifa është e barabartë me shumën që rezulton prej mbledhjes së vlerës së tarifës të përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike dhe vlerës së parapaguar të shpenzimeve të udhëtimit dhe qëndrimit.

4. Për kryerjen e njoftimit të akteve gjyqësore, vlera e tarifës përlogaritet si më poshtë:

a) kur nuk kryhet njoftimi në adresën e deklaruar dhe adresa e deklaruar është e saktë, tarifa është 5 000 (pesë mijë) lekë;

b) kur nuk kryhet komunikimi në adresën e deklaruar dhe adresa e deklaruar është e pasaktë, tarifa është e barabartë me shumën që rezulton prej mbledhjes së vlerës prej 7 000 (shtatë mijë) lekësh dhe tarifës për konstatimin e adresës, të parashikuar në udhëzimin në fuqi të ministrit të Drejtësisë;

c) në një njësi administrative tjetër/të ndryshme të një qarku tjetër, tarifa është e barabartë me shumën që rezulton prej mbledhjes së vlerës së tarifës të përcaktuar në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike dhe vlerës së parapaguar të shpenzimeve të udhëtimit dhe qëndrimit.

5. Për efekt të llogaritjes së tarifës të përcaktuar në pikat 2 deri 4 të këtij kreu, vlera e shpenzimeve të udhëtimit dhe qëndrimit nuk mund të jetë më e ulët se:

a) 9 000 (nëntë mijë) lekë, për distancën që varion nga 50 km deri në 100 km;

b) 18 000 (tetëmbëdhjetë mijë) lekë, për distancën që varion nga 100 km deri në 150 km;

c) 20 000 (njëzet mijë) lekë, për distancën që varion nga 150 km deri në 200 km;

ç) 22 000 (njëzet e dy mijë) lekë, për distancën që varion nga 200 km deri në 300 km;

d) masa e një page minimale në shkallë vendi, për distanca mbi 300 km.

IV. Mënyra e pagimit të tarifës së shërbimit të njoftimit të dokumenteve zyrtare dhe/ose akteve

1. Tarifa e përcaktuar në pikat 2 dhe 3 të kreut III të këtij Udhëzimi paguhet nga personi fizik ose juridik, publik ose privat, nëpërmjet sistemit bankar, në llogarinë e përmbaruesit gjyqësor privat për administrimin e aktivitetit tregtar si person fizik ose juridik.

2. Tarifa e përcaktuar në pikën 4 të kreut III të këtij udhëzimi paguhet nga pala së cilës i janë ngarkuar shpenzimet nga gjykata, në llogarinë e përmbaruesit gjyqësor privat për administrimin e aktivitetit tregtar si person fizik ose juridik.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

MINISTËR I DREJTËSISË

Ulsi Manja
ULSI MANJA

